



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 275/25, Datë: 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028):
 - *Programi Fillor, BA 240 ECTS, R (në 3 gjuhë), me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik, (50 në gjuhën shqipe, 25 në gjuhën boshnjake dhe 25 në gjuhën turke).*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri me 30 shtator 2025, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren të raportoj dhe arsyetoj në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Programi Fillor, BA (në 3 gjuhë) 240 ECTS, R	Shemsi Morina, Vedat Bajrami, Esad Kurejsepi, Soner Jildirim Gjylë Totaj Salihu, Mynever Muyo Yildirim

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit AKA ka organizuar vizitë në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Programi Fillor BA 240 R (në 3 gjuhë), vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Miklos Hoffmann dhe Elisa Knief është organizuar më 06.02.2025 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.

Duke u bazuar në faktin se në raportin final të ekipit të ekspertëve, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren kishte përmbushur plotësisht vetëm një (1) fushë të standardeve ndërsa gjashtë (6) prej fushave ishin substancialisht, KShC në bazë të diskrecionit të saj vendosi që ky program të Riakreditohet për periudhën tre (3) vjeçare, përkundër rekomandimit të ekipit të ekspertëve që kishin rekomanduar akreditim 5 vjeçar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 135-të, të mbajtur më datë 10.03.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi



Vendimi iu dërgohet:

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

- Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.